

Përmbledhje



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

SUBJEKT I MONITORUAR: NURJETA POGACE, GJYQTARE, GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR, DURRËS

**RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE
DATË 31/10/2022 PRANË KPK:**

-  Kriteri i pasurisë: Raporti nga ILDKPKI, në përputhje me nenin 33 të ligjit 84/2016, u citua si deklaram i saktë në përputhje me ligjin, nuk rezultoi fshehje pasurie, jo deklaram i rremë dhe jo konflikt interesi lidhur me mënyrën e fitimin të pasurisë
-  Kriteri i kontrollit të figurës: Raporti i ardhur nga DSIK në datën 04.06.2022 konfirmonte përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për znj. Pogace. Nga hetimi i thelluar i KPK rezultoi një proces penal dhe dënim i vuajtur nga vëllai i subjektit në Itali., ku nuk përputhen deklaramet e bëra të subjektit me informacionet e ardhura nga institucionet e drejtësisë në Itali lidhur me dënimin e dhënë
-  Mbi rivlerësimin e aftësive profesionale: Lidhur me aftësitë profesionale subjekti i rivlerësimit vlerësohet për aftësi shumë të mira në interpretim dhe zbatim të ligjit, respekton afatin kohor në gjykimin e çështjeve, arsyetim i bërë në kohë dhe eficiente në punën në saj.



Subjekti i rivlerësimit Znj. Nurjeta Pogace përballë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Më 31 tetor 2022, u zhvillua seanca dëgjimore e znj. Nurjeta Pogace, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për shkak të funksionit si gjyqtar, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016). Trupi gjykues përbëhej nga Roland Ilia (Kryesues), Pamela Qirko (Relatore) dhe Brunilda Bekteshi (Anëtare). Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar ishte e pranishme znj. Marie Tuma, e cila gjatë seancës dëgjimore mbajti qëndrim korrekt në përputhje me etikën por nuk ndërhyri dhe as nuk drejtoi pyetje ndaj subjektit në rivlerësim.

Subjekti i rivlerësimit kishte zgjedhur të paraqitej pa praninë e një mbrojtësi ligjor dhe nuk ngriti kërkesa paraprake lidhur me njëanshmërinë gjatë procesit apo konflikt interesi të trupës së rivlerësimit.

Gjithashtu KPK relaton se subjekti i rivlerësimit është njoftuar për: (i) rezultatet e hetimit kryesisht (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr.84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 – 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

Proçesi i rivlerësimit për subjektin ishte realizuar mbi bazën e 3 kriterëve: Kriterin e pasurisë, Kriterin e aftësive profesionale dhe Kriterin e pastërtisë së figurës, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Raporti nga ILDKPKI, në përputhje me nenin 33 të ligjit 84/2016, u citua si deklaram i saktë në përputhje me ligjin, nuk rezultoi fshehje pasurie, jo deklaram i rremë dhe jo konflikt interesi lidhur me mënyrën e fitimit të pasurisë. Edhe pse u deklarua përgjithësisht i saktë u evidentua një problematikë në lidhje me sipërfaqen e deklaruar të një shtëpie banimi. Subjekti i rivlerësimit sqaroi se mospërputhja ka të bëjë me faktin se deklarimi i sipërfaqes është paraqitur në total pa bërë diferencë midis truallit dhe objektit të shtëpisë përt të cilën u tregua e gatshme të paraqiste dokumentacionin e nevojshëm.

Pavarësisht se seanca ishte publike, trupa gjykuese nuk relatoi objektin e ankesave të ardhura në drejtim të subjektit por u evidentua që janë bërë 11 denoncime dhe 5 ankesa pranë ONM, ku për 6 prej tyre i ishte kaluar barra e provës. Subjektit iu dha mundësia për tu dëgjuar lidhur me parashtrimet e saj, e cila e realizoi këtë të drejtë në mënyrë të përmbledhur. Subjekti i rivlerësimit theksoi se ankesat ishin të pabazuara në ligj dhe për secilin prej tyre dha shpjegime pa referuar detaje.

Raporti i ardhur nga DSIK në datën 04.06.2022 konfirmonte përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për znj. Pogace. Nga hetimi i thelluar i KPK rezultoi një proces penal dhe dënim i vuajtur nga vëllai i subjektit në Itali. Sipas KPK nuk përputhen deklaramet e bëra të subjektit me informacionet e ardhura nga institucionet e drejtësisë në Itali lidhur me dënimin e dhënë.

Lidhur me aftësitë profesionale subjekti i rivlerësimit vlerësohet për aftësi shumë të mira në interpretim dhe zbatim të ligjit, respekton afatin kohor në gjykimin e çështjeve, arsyetim i bërë në kohë dhe eficiente në punën në saj.

Znj. Nurjeta Pogace rikonfirmohet në detyrë sipas seancës për shpalljen e vendimit datë 02.11.2022.